



**VENDIM**

**Nr. 56, Datë 29.04.2016**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË  
“DEVOLL HYDROPOWER” SH.A NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT  
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “ç” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “f”; 5, pika 1 gërma ‘f’ ; 10 pika 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 108, datë 09.09.2008 dhe nenit 18 pika 1 gërma “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21 datë 18.03.2009, te ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.04.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për liçensimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

**Konstatoi se :**

Aplikimi i shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërma ‘a’, ‘b’ dhe ‘c’) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërma ‘a’, ‘b’, ‘c’, ‘d’, ‘e’) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërnat ‘b’, ‘c’, ‘d’) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizuesit të energjisë elektrike (neni 9, pikat 4/9 gërma ‘a’, ‘b’ dhe ‘c’) është plotësuar në mënyrë korrekte.

**Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:**

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërma ‘a’)

do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesëhëm dhe Rinovimit të Liçensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

- Të fillojë procedurat për licensimin e shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.
- Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**

**Petrit AHMETI**